

DEPARTAMENTI



BANKA E SHQIPËRISË

Për të ruajtur integritetin e institucionit të bankës qendrore; për të siguruar zbatim të rregullave dhe ligjeve dhe administrim efikas të tij si dhe për të mbrojtur institucionin nga abuzimet, mashtrimet dhe vjedhjet funksionon njësisia e kontrollit të brendshëm. Që ky funksion të ushtrohet në mënyrë të pavarur dhe të jetë i lirë nga presioni i administratorëve të bankës qendrore, Departamenti i Kontrollit drejtohet nga Inspektori i Përgjithshëm, i cili zgjidhet nga Kuvendi për një afat prej 5 vjetësh.

Elementet më të rëndësishem të përmbushjes së këtij funksioni janë:

- ushtrimi i kontrollit kontabël të brendshëm;
- paraqitja në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë e raporteve dhe e rekomandimeve për llogaritë dhe për regjistrat, si dhe për procedurat buxhetore, kontabël dhe kontrollet e Bankës së Shqipërisë;
- kontrolli i raporteve periodike financiare dhe i dokumenteve të lidhura me to si edhe nxjerrja e certifikatës për këtë qëllim.

Departamenti kontrollon raportin financiar përfundimtar dhe raportet periodike të përgatitura nga Banka e Shqipërisë; vlerëson aktivitetin e degëve të Bankës së Shqipërisë, duke përfshirë vlerësimin e marrëdhënieve me sistemin bankar.

Banka e Shqipërisë ka funksionuar në kushtet e një shkalle të ulët të automatizimit të veprimeve. Në vijim të punës për automatizimin e veprimeve, synimi i departamentit është që të kontrollojë dhe të ndikojë në instalimin e sistemeve të kontrollit për t'u siguruar se, në çdo vend, janë vendosur sisteme të mjaftueshme kontrolli, të cilat sigurojnë mbrojtjen nga rreziqet e mundshme apo nga gabimet serioze dhe garantojnë veprimtari normale.

Në kushtet aktuale të zhvillimeve të brendshme, të nevojës së thellimit të reformave e të kërkesave të paraqitura nga institucionet ndërkombëtare, në përputhje edhe me vetë dinamikën e zhvillimeve në to, strategjia e zhvillimit të departamentit në të ardhmen do të synojë në:

1. Kryerjen e funksionit të auditit të brendshëm sipas standardeve ndërkombëtare.

Për këtë kërkohet:

- a. kryerja e auditimeve të brendshme të jetë në përputhje me standardet për praktikën profesionale të auditit të brendshëm;
- b. sjelljet e auditorëve të jenë në përputhje me kodin e etikës së auditorëve të brendshëm, të pranuar këto nga mjaft organizata e institute të auditorëve të vendeve të tjera;
- c. lidhje e vazhdueshme me organizatat e auditorëve të brendshëm, për të njohur ndryshimet e tyre si dhe adoptimet përkatëse nga organizmat që rregullojnë këto standarde për bankat qendrore.

2. Transformimin e karakterit të funksionit të auditit të brendshëm nga prapaveprues në parandalues, duke marrë kështu një rol aktiv në parandalimin e fenomeneve dhe në rritjen e eficiencës së tij. Për këtë, do të punohet në drejtim të:

- a. rivlerësimin të rrezikut për të gjitha funksionet e bankës, bazuar në metodat moderne që përdoren aktualisht nga bankat qendrore, duke iu përshtatur kushteve të reja të punës në bankë dhe përdorimit të sistemeve të reja të kontabilitetit;
- b. paraqitjes së vendosjes së sistemit të kontrollit të brendshëm, sipas funksioneve të veçanta të bankës si dhe mbikëqyrja e vazhdueshme e ndryshimeve që ndodhin në të, me qëllim realizimin e uljes së rrezikut të gabimeve që mund të ndodhin ose rritjen e mundësive për zbulimin e shpejtë të tyre;
- c. përgatitja e kushteve për instalime të programeve bashkëkohore të auditit, në përputhje me llojet, me strukturën dhe me veprimtarinë operationale të bankës;
- d. krijimi i një historiku të vlerësimin të rrezikut sipas funksioneve dhe auditeve të kryera, duke bërë të mundur që mbi baza rotacionale t'i jepet përparësi fushës me rrezik më të lartë, duke bërë të mundur jo vetëm identifikimin e faktorëve që ndikojnë në to, por edhe ecurinë e tyre, duke synuar mbajtjen e tyre gjithnjë në nivele të pranueshme;
- e. plotësimi i procedurave operative standarde për planifikimin dhe për dokumentimin e punës së kryer, në përshtatje me standardet ndërkombëtare dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

3. Rritjen e efektivitetit dhe të eficiencës së veprimtarisë së Departamentit të Kontrollit.

- a. Njohja e teknikave bashkëkohore në vlerësimin e efektivitetit dhe të eficiencës në veprimet operationale dhe administrative të Bankës së Shqipërisë, me qëllim të dhënies së vlerësimeve të drejta për ato të kryera dhe rekomandimet e duhura për përmirësimin e treguesve të tyre në të ardhmen.
- b. Ngritja e vazhdueshme e nivelit të punonjësve të ngarkuar me detyra të kontrollit e të auditit të bankës, duke u ingranuar jo vetëm me literaturën e huaj përkatëse e seminare në vende të huaja.